



UNIVERSITETI “ALEKSANDËR XHUVANI” ELBASAN

RREGULLORE

E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TE SENATIT TE UE^{së}

Miratuar në mbledhjen e Senatit Akademik me Vendimin Nr 20 datë 14. 06.2012

KRYETARI I SENATIT

Prof.dr. Liman VAROSHI

Neni 1

Senati Akademik është organ kolegjal vendimmarrës i zgjedhur në nivel Universiteti. Veprimtaria e Senatit të UE-së mbështetet në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Statutin e Universitetit “Aleksandër Xhuvani *Elbasan*”,

Neni 2

Senati akademik është organi më i lartë i UE-së, i cili përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre.

Neni 3

Senati akademik ka këto funksione kryesore :

1. Garantton respektimin e parimeve të autonomisë dhe të mundësive të barabarta të lirisë akademike e të kërkimit shkencor, si dhe të drejtat e studentëve;
2. Miraton planin disavjeçar të zhvillimit të UE dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
3. Vendos me shumicën e votave të anëtarëve të tij projekt-buxhetin e UE, pasi merr miratimin nga Këshilli i administrimit;
4. Miraton ndarjen e burimeve financiare;
5. Miraton projektstatutin e UE me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij;
6. Vlerëson hapjen apo mbylljen e programeve të reja të studimit në UE, të kërkimit dhe të zhvillimit, apo pjesë të tyre, te cilat me pas ia dërgon MASH për miratimin e tyre.
7. Vlerëson dhe miraton hapjen, ndryshimin ose mbylljen e njësive mësimore ose kërkimore - shkencore;

8. Miraton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore, si dhe atë financiar, në një mbledhje të hapur për gjithë personelin akademik e administrativ dhe për studentët.
9. Vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UE, në përputhje me standardet shtetërore;
10. Vlerëson veprimtarinë mësimore-kërkimore të personelit akademik;
11. Siguron që kryerja dhe vlerësimi i të gjitha provimeve të bëhet në përputhje me standardet e arsimit të lartë, duke garantuar cilësinë dhe transparencën e duhur;
12. Kërkon mendimin e Këshillit të administrimit për probleme që janë kompetencë e këtij të fundit. I propozon MASH kuotat dhe kritere të veçanta të pranimeve në UE, si dhe tarifat e regjistrimit dhe të studimeve;
13. Përcakton kriteret e pranimi për kandidatë në ciklin e dytë të studimeve, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve, si dhe i propozon MASH kuotat përkatëse;
14. Miraton në parim marrëveshjet apo kontratat e bashkëpunimit me të tretët, që do të nënshkruajë Rektori, në emër dhe për llogari të UE-së;
15. Miraton paraprakisht hapjen e filialeve, krijimin e qendrave apo kurseve të posaçme, si dhe projekteve të tjera të shërbimit që ofrohen nga fakultetet, bazuar në propozimin e Këshillit të fakultetit përkatës;
16. Miraton rregulloren e brendshme të tij;
17. Miraton rregulloret e UE-së që janë kompetencë e tij.

Neni 4

Senati akademik përbëhet nga Rektori dhe përfaqësues të zgjedhur me votim të fshehtë nga personeli akademik, personeli joakademik dhe nga studentët, të zgjedhur sipas procedurave të përcaktuara në “*Rregulloren e zgjedhjeve të UE*”.

Neni 5

Senati akademik kryesohet nga Rektori, i cili është kryetar i tij. Në mungesë të tij mbledhjen e drejton nënkryetari.

Neni 6

Nga anëtarët e tij Senati akademik zgjedh nënkryetarin dhe sekretarin e tij. Senati akademik ka nënkryetarin e tij, i cili zgjidhet nga anëtarët e Senatit.

Neni 7

Për të lehtësuar funksionimin e brendshëm të Senatit Akademik, për vlerësimin paraprak të propozimeve që i paraqiten atij, krijohen komisionet e përhershme të Senatit:

- a. Komisioni i punës mësimore
- b. Komisioni i punës kërkimore shkencore
- c. Komisioni politikave të zhvillimit e akreditimit
- d. Komisioni i buxhetit dhe investimeve
- e. Komisioni i marrëdhënieve me jashtë

Detyrat e anëtarëve të komisioneve përrputhen me misionin që ka secili komision, sipas fushës që mbulon.

Neni 8

Senati akademik mblidhet në seanca të zakonshme, si rregull 1 herë në muaj, në përputhje me programin e punës të publikuar në fillim të çdo viti akademik.

Senati mund të mblidhet edhe në seanca të jashtëzakonshme, me iniciativën e kryetarit të Senatit ose me kërkesën e një të tretës të anëtarëve të tij. Në rastin kur Senati mblidhet me kërkesën e një të tretës së anëtarëve të tij, rendi i ditës propozohet nga grupi i anëtarëve propozues.

Neni 9

Mbledhjet e Senatit dhe të komisioneve të tij, janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se dy të tretat e anëtarëve të brendshëm të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të të pranishmëve në mbledhje.

Për rastet kur kërkohen ndryshime të Statutit të UE-së apo të Rregulloreve të tij, vendimet merren me jo më pak se 2/3 e votave “pro” të anëtarëve të Senatit.

Neni 10

Votimet në Senat, si rregull, bëhen të hapura.

Votimet në Senat mund të bëhen të fshehta kur kjo kërkohet nga kryetari i Senatit ose nga një e treta e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 11

Mbledhjet e Senatit thirren me një rend dite të propozuar nga kryetari. Njoftimi për mbledhjen e Senatit u dërgohet anëtarëve të tij, pasi janë shprehur komisionet, jo më pak se pesë ditë nga data e zhvillimit të mbledhjes.

Njoftimin e organizon rektorati.

Neni 12

Materialet që i paraqiten për shqyrtim Senatit, vlerësohen paraprakisht nga komisionet e përhershme të tij, të cilët i shprehin Senatit me shkrim vlerësimin e tyre.

Në rast se Komisioni nuk bie dakord me një material të caktuar, ka të drejtë ta kthejë atë për ripunim.

Materialet që do të shqyrtohen në mbledhjen e senatit depozitohen në Rektorat.

Neni 13

Procedura e mbledhjes së Senatit dhe diskutimet e zhvilluara në të pasqyrohen në proces-verbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga Kryetari Senatit, një anëtar dhe mbajtësi i tij.

Proces-verbalet e mbledhjeve të Senatit arkivohen.

Neni 14

Vendimet e Senatit nënshkruhen nga kryetari i tij dhe bëhen publike brenda pesë ditëve nga përfundimi i mbledhjes përkatëse.

Vendimet hartohen në dy kopje, njëra prej të cilave arkivohet dhe tjetra i dërgohet njësisë/njësive përkatëse për zbatim.

Neni 15

Mandati i senatit është katër – vjeçar.

Mandati i anëtarit të senatit merr fund kur :

- përmushet afati i mandatit;
- jep dorëheqjen;
- largohet nga UE;
- bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;

- nuk merr pjesë, për tre herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjet e Senatit akademik.
- kur dënohet me vendim gjyqësor t formës së prerë.

Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas “*Rregullores së zgjedhjeve*”.

Neni 16

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit në Senatin Akademik dhe firmosjes nga Kryetari tij.

Miratuar me Vendimin Nr. 20 të senatit Akademik, datë 14.06.2012